



**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**



Ne Tirane sot me daten 07.08.2001, ndermjet ortakëve Julian Mane, Fatmir Mane dhe Zamir Mane, shtetas shqiptare, banues ne Tirane, si themelues te kesaj shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, u ra dakord dhe u vendos te hartohet ky Akt Themelimi, mbeshetur ne Legjislacionin shqiptar dhe ne parimet e meposhtme:

**Neni 1**

Themeluesit e kesaj shoqerie krijojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar te cilen do ta quaje "Mane SH.P.K."



**Neni 2**

Selia e shoqerise do te jete ne Rr. Jordan Misja tek ish UMB, Tirane. Me vendim te ortakëve te shoqerise mund te hapen seli sekondare, filiale ose forma te tjera shoqerish, ashtu sikunder do ta shikoje te nevojshme shoqeria, brenda dhe jashte Shqiperise.

**Neni 3**


Kohezgjatja e shoqerise do te jete per nje afat te pacaktuar, por sidoqofte mbi 10 vjet dhe do te filloje qe nga momenti I regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar, me perjashtim te rastit kur mbaron sipas parashikimeve ne ligj ose kur vendosin ortakët.

**Neni 4**

Si objekt I veprimtarise se shoqerise do te jete eksportimi dhe importimi I mallrave industriale dhe ushqimore si dhe shitja me shumice dhe me pakice e mallrave industriale dhe ushqimore.

**Neni 5**

Kapitali themeltar I shoqerise do te jete 500.000 leke, I zoteruar I gjithi nga ortakët e shoqerise ne keto kuota:



Fatmir Mane 90%  
Zamir Mane 9%  
Julian Mane 1%.

Fitimi neto I shoqerise do te ndahet ndermjet ortakeve ne kuotat e kapitalit social.

#### Neni 6

Kapitali themeltar eshte depozituar prej ortakeve ne nje Banke ne Shqiperi, me nje llogari te hapur ne emer te shoqerise ne formim e siper.

Shuma e depozituar vertetohet me ane te nje certifikate te leshuar nga ajo Banke, ne te cilen shenohet shuma e kapitalit te derdhur.

#### Neni 7

Shoqeria do te rregullohet pervec ketij Akti Themelues edhe me norma te percaktuara ne Statutin e saj, I cili do te nenshkruhet nga ortaket dhe si I tille do te miratohet ne Gjykatën e Rrethit Tirane ne ditën e legalizimit si person juridik ne Shqiperi.

Administrator I shoqerise do te jete Julian Mane.

#### Neni 8

Ky Akt Themelimi eshte hartuar ne tre ekzemplare, ne gjuhen shqipe, duke patur secili ekzemplar fuqi te njejte ligjore.

#### THEMELUESIT

Fatmir Mane



Zamir Mane



Julian Mane

Julian Mane

